21) Importi i mjetit motorik është futja e mjetit motorik në territorin doganor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përveç nëse pas futjes në territorin doganor, ai vihet në procedurat e veçanta, si dhe lëshimi i mjetit nga procedurat e veçanta në pajtim me rregullat doganore, duke e përfshirë edhe importimin e përkohshëm;

22) Nomenklatura e Tarifës doganore është nomenklatura në pajtim me Ligjin për Tarifë doganore dhe

23) Organi doganor kompetent është Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe njësitë e saj organizative.

Neni 4

Relacioni me ligjet e tjera

(1) Për të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar me këtë ligj, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë tatimore, Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative dhe Ligjit për automjete.

(2) Për të gjitha çështjet lidhur me importin, importin e përkohshëm dhe eksportin e mjeteve motorike që nuk rregullohen me këtë ligj, zbatohen dispozitat e Ligjit doganor.

(3) Në aspektin e klasifikimit të lëndës së tatimitit në shenjë tarifore të nomenklaturës së kombinuar vendos për organi doganor kompetent në pajtim me rregullat doganore dhe parimet themelore që shfrytëzohen për klasifikimin e mallrave në Tarifën doganore.

Neni 5

Lloji i taksës

Tatimi mbi mjetet motorike është tatim publik dhe janë të ardhura në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PJESA E DYTË

DISPOZITAT E TATIMITIT TË MJETEVE MOTORIKE

KAPITULLI 2

LËNDA E TATIMITIT, OBLIGUESI PËR PËRLLOGARITJEN DHE PËR PAGESËN E TATIMIT MBI MJETET MOTORIKE

Neni 6

Lënda e tatimitit

(1) Lënda e tatimitit me tatim të mjeteve motorike janë mjetet e reja dhe të përdorura motorike që importohen dhe/ose vihen për herë të parë në qarkullim të lirë dhe/ose

për herë të parë regjistruhen në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për të cilat nuk është përlogaritur dhe paguar tatimi mbi mjetet motorike, edhe atë:

1) mjete udhëtarësh dhe mjete të tjera motorike të dizajnuara kryesisht për transportin e personave, duke i përfshirë mjetet motorike për transportin e kombinuar të personave dhe mallrave nga lloji i karvanit, furgonëve dhe të ngjashme; mjete sportive të përshtatura për përdorimin e rrugëve nga shenjat tarifore nga Nomenklatura e Tarifës Doganore: 8703 21, 8703 22, 8703 23, 8703 24, 8703 31, 8703 32, 8703 33 dhe 8703 90, përveç mjeteve të ambulancës, "van" mjeteve të arritshme dhe mjeteve funerale;

2) mjetet e udhëtarëve që lëvizin me fuqi elektrike hibride (kombinimi i motorit me djegie të brendshme dhe me motor elektrik si motor me fuqi) dhe atë:

- me mundësinë të mbushen me lidhje në burimin e jashtëm të rrymës elektrike "plug-in", të shenjave tarifore 8703 60 dhe 8703 70 dhe

- me mundësinë të mbushen me lidhje në burimin e jashtëm të rrymës elektrike, të shenjave tarifore 8703 40 dhe 8703 50.

3) Motoçikletë (duke i përfshirë edhe mopedët), skuterët dhe mjetet e ngjashme me ose pa rimorkio anësore nga shenjat tarifore nga Nomenklatura e Tarifës Doganore: 8711 20, 8711 30, 8711 40, 8711 50 dhe 8711 90;

4) Mjetet "pick-up" me kabinë të dyfishtë, pavarësisht nga shenja e tyre tarifore në Nomenklaturën e Tarifës Doganore;

5) triçiklet dhe katërçikletat me vëllim të motorit më të madh se 50 cm³, pavarësisht nga shenja e tyre tarifore në Nomenklaturën e Tarifës Doganore dhe

6) mjetet motorike të llojit tjetër të riparuar në mjetet motorike nga pikat 1), 2), 3), 4) dhe 5) të këtij paragrafi.

(2) Lëndë e tatimit me tatim mbi mjetet motorike janë edhe mjetet e regjistruara motorike në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga lloji tjetër që janë riparuar në mjete motorike nga paragrafi (1) pika 6) të këtij neni.

(3) Mjetet motorike që nuk janë lëndë e tatimit me tatim mbi mjetet motorike janë:

1) mjetet e udhëtarëve që lëvizin vetëm me fuqi motori elektrik nga shenja tarifore 8703 80;

2) motoçikletat dhe skuterët vetëm me motor elektrik për fuqi nga shenjat tarifore 8711 60 dhe

3) triçiklet dhe katërçiklet vetëm me motor elektrik për fuqi pavarësisht nga shenja e tyre tarifore në Nomenklaturën e Tarifës Doganore.

Neni 7

Obligues për pagesën e tatimit të mjeteve motorike

(1) Obligues për pagesën e tatimit për mjete motorike (në tekstin në vijim: Tatimpaguesi) është personi i cili:

1) prodhon ose furnizon mjete motorike nga neni 6 paragrafi (1) të këtij ligji të prodhuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shkak të shitjes ndaj blerësit përfundimtar ose shfrytëzim për nevoja të veta;

2) është pronar i automjetit motorik paraprakisht të aprovuar nga lloj tjetër në të cilin është kryer riparimi në automjetin motorik nga neni 6 paragrafi (1) pika 6) dhe paragrafi (2) të këtij ligji;

3) importon automjete motorike nga neni 6 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

4) në mënyrë joligjore përdor automjet motorik nga neni 6 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

(2) Si obligues për pagesën e tatimit për automjet motorik për përdorim joligjor të mjetit motorik nga paragrafi (1) pika 4) të këtij neni do të konsiderohet edhe çdo person i cili në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

1) ka ditur ose sipas rrethanave të rastit është dashur të dijë se përdorimi dhe ndërmjetësimi i automjetit motorik është joligjor dhe

2) ka fituar në pronësi ose në përdorim mjet motorik dhe i cili ka ditur ose sipas rrethanave të rastit është dashur të dijë se automjeti motorik përdoret në mënyrë joligjore.

(3) Nëse më tepër persona janë përgjegjës për pagesën e tatimit mbi mjetin motorik, për pagesën përgjigjen në mënyrë solidare.

Neni 8

Obligimi për përlogaritje dhe pagesë të tatimit mbi mjete motorike

(1) Obligim për përlogaritje dhe pagesë të tatimit mbi mjete motorike nga neni 6 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji shkaktohet kur:

1) prodhuesi ose tregtari me automjete të reja motorike të prodhuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, lëshojnë dokument për shitje të mjeteve motorike për blerësin përfundimtar ose i përdorin për nevojat e veta;

2) bëhet riparimi i automjeteve motorike të aprovuara nga lloj tjetër në mjet motorik nga neni 6 paragrafi (1) pika 6) dhe paragrafi (2) të këtij ligji dhe

3) bëhet importi i mjetit motorik, në momentin e shkaktimit të borxhit doganor në pajtim me dispozitat doganore.

(2) Obligimi për përlogaritjen dhe pagesën e tatimit për mjetin motorik shkaktohet edhe kur do të konstatohet përdorim joligjor i mjetit motorik në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Obligimi për përlogaritje dhe pagesë të mjetit motorik nuk shkaktohet kur mjete të reja motorike të prodhuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut i furnizojnë tregtarë me mjete të reja motorike për

shkak të shitjes së mëtutjeshme, deri në momentin kur të njëjtit shesin si blerës përfundimtar ose përdoren për nevoja vetjakë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KAPITULLI 3

PËRLLOGARIJTA E TATIMIT PËR MJETE MOTORIKE

Neni 9

Të dhëna për përllogaritjen e tatimit mbi mjete motorike

(1) Tatimi mbi mjetet motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 1), 2) dhe 4) të këtij ligji dhe mjetet motorike të aprovuara në të cilat është bërë riparimi nga lloj tjetër i mjetit motorik nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1), 2) dhe 4) të këtij ligji do të përllogaritet në bazë të të dhënave për shumën e emetimit mesatar të dyoksidit të karbonit - CO₂, e shprehur në gram për kilogram, informacion për shumën e tatimit të mjetit motorik për 1 gram dyoksid karbon - CO₂, për kategorinë përkatëse në varësi të llojit të karburantit që përdoret për motor të mjetit të shprehur në denarë, informacion për vlerën e shitjes së automjetit pa tatim të përllogaritur të vlerës së shtuar të shprehur me euro në kundërvlerë të denarit sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e përllogaritjes ose gjatë informacionit për import për vlerën doganore të mjetit të përcaktuar në pajtim me dispozitat doganore dhe të dhëna për shumën e doganës, të shprehur me euro në kundërvlerë të denarit të përllogaritur sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e importit, si dhe informacionin për kategorinë përkatëse.

(2) Tatimi mbi mjetet motorike nga paragrafi (1) të këtij neni përllogaritet si shumë e vlerës dhe komponentët specifike. Komponenti i vlerës është produkt i vlerës së mjetit motorik të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni dhe përqindja e vlerës së mjetit për kategori përkatëse të vlerës, ndërsa komponenti specifik i prodhimit të shumës së emetimit mesatar të dyoksidit të karbonit - CO₂, dhe vlera për 1 gram dyoksid karbon - CO₂, për kategorinë përkatëse në varësi të llojit të karburantit i cili përdoret për motorin e mjetit.

(3) Me përjashtim të dispozitave nga paragrafi (1) të këtij neni, tatimi i mjeteve motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 2) alineja 1 të këtij ligji, përllogaritet në shumë të zvogëluar për 50% të tatimit të përllogaritur të mjetit motorik nga paragrafi (2) të këtij neni.

(4) Me përjashtim të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni, tatimi i mjeteve motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 4) të këtij ligji dhe mjetet motorike të aprovuara në të cilat është kryer riparimi nga lloj tjetër i mjeteve

motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 4) të këtij ligji, ndërsa të cilat shpërndahen në shenjë tarifore 8704, përllogaritet në bazë të të dhënave për forcën e motorit të shprehur me -kW, informacion për shumën e tatimit të mjetit motorik për 1kW të shprehur në denarë për kategorinë përkatëse dhe nivelin e emetimit të gazrave.

(5) Tatimi për mjetet motorike nga paragrafi (4) i këtij neni përllogaritet si prodhim i shumës së forcës së motorit të shprehur në kilovatë - KW dhe vlera e një kW në varësi të nivelit të emetimit të gazrave dalëse.

(6) Tatimi i mjeteve motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 3) dhe 5) të këtij ligji dhe mjetet motorike të aprovuara në të cilat është kryer riparimi nga lloj tjetër i mjeteve motorike nga neni 6 paragrafi (1) pikat 3) dhe 5) të këtij ligji, përllogaritet në bazë të të dhënave për forcën e motorit të shprehur me centimetra kub - cm³, informacion për shumën e tatimit të mjetit motorik për 1 cm³, të shprehur në denarë për kategorinë përkatëse dhe nivelin e emetimit të gazrave.

(7) Tatimi për mjetet motorike nga paragrafi (6) i këtij neni përllogaritet si prodhim i shumës së forcës së motorit të shprehur në kilovatë - KW dhe vlera e një kW në varësi të nivelit të emetimit të gazrave dalëse.

(8) Me përjashtim të dispozitave nga nenet (6) dhe (7) të këtij neni, për të gjitha mjetet motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 3) të këtij ligji, të cilat janë prodhuar para 35 e më tepër vite, ndërsa të cilat në pajtim me dispozitat e Ligjit për automjete nuk kanë status të përcaktuar të automjetit me vlerë historike "oldtajmer", tatimi i mjetit motorik përllogaritet dhe paguhet në shumë paushall prej 5.000.00 denarësh.

(9) Automjetet motorike nga paragrafi (8) i këtij neni do të tatimohen në pajtim me paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni nëse të njëjtat përdoren për marrje me qira, shpërbllim, ose përdoren për tregti ose aktivitet tjetër afarist.

(10) Gjatë importit të automjeteve motorike, tatimin për automjetet motorike e përcakton dhe arkëton organi doganor kompetent, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të dhënat nga paragrafët (1), (4), (6) dhe (8) të këtij neni, të dorëzuara nga importuesi, përkatësisht nga tatimpaguesi doganor të definuara në pajtim me rregullat doganore.

(11) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e përcakton mënyrën e përllogaritjes së tatimit mbi mjete motorike nga paragrafët (2), (5) dhe (7) të këtij neni dhe i përcakton shumat e nevojshme për llogaritjen e tatimit mbi mjete motorike, në bazë të kriterëve të theksuara në paragrafët (1), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij neni.

Neni 10

Baza për përlogaritjen e tatimit mbi mjete motorike

(1) Baza për përlogaritjen e tatimit mbi mjete motorike gjatë prodhimit të mjeteve motorike nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1), 2) dhe 4) të këtij ligji ose gjatë rregullimit të mjeteve motorike të miratuar të llojit tjetër në mjetet motorike nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1), 2) dhe 4) të këtij ligji është shuma e emisionit mesatar të dyoksidit të karbonit - CO₂ i shprehur në gram për kilometër në varësi të llojit të fuqisë motorike dhe vlerës së shitjes së automjeteve me vlerën e shtuar të pajisjeve të montuara shtesë, në të cilën nuk është i përfshirë tatimi mbi vlerën e shtuar.

(2) Baza për përlogaritje të tatimit mbi mjete motorike gjatë importit ose gjatë importit të përkohshëm të mjeteve motorike nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1), 2) dhe 4) të këtij ligji është shuma e emisionit mesatar të dyoksidit të karbonit CO₂ i shprehur në gramë për kilometra në varësi të llojit të fuqisë motorike dhe vlerës së doganës së mjetit motorik të përcaktuar në pajtime me rregullat doganore e rritur me shumën e doganës.

(3) Bazat për përlogaritjen e tatimit mbi mjete motorike gjatë prodhimit, importit dhe importit të përkohshëm të automjeteve motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 3) dhe 5) të këtij ligji, si dhe për rregullimin e automjeteve motorike të miratuara të llojit tjetër në automjete motorike nga neni 6 paragrafi (1) pikat 3) dhe 5) të këtij ligji është vëllimi i motorit të shprehur në centimetër kub - cm³ dhe nivelin e emisionit të gazrave të shkarkuara.

(4) Me përjashtim të dispozitave nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, baza për llogaritjen e tatimit mbi mjete motorike gjatë prodhimit, importit dhe importit të përkohshëm të automjeteve motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 4) të këtij ligji, si dhe gjatë rregullimit të automjeteve motorike të miratuara të llojit tjetër në automjete motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 4) të këtij ligji, ndërsa të cilat klasifikohen në shenjë tarifore 8704, është fuqia e motorit e shprehur në kilovat - kW dhe nivelin e emisionit të gazrave të shkarkuara.

Neni 11

Përcaktimi i të dhënave për përlogaritjen e tatimit mbi mjete motorike

(1) Me kërkesë të organit doganor kompetent, tatimpaguesi për pagesë të tatimit mbi mjete motorike është i detyruar të dorëzojë fatura, dërgesa, marrëveshje për shit-blerje, certifikata për përshtatje me BE-marrëveshjen e automjeteve (certificate of conformity-COC) dokumentet komerciale, tregtare, zyrtare ose të tjera dhe dëshmi të disponueshme, ndërsa janë të nevojshme për përcaktimin e drejtë dhe të saktë të të dhënave për përlogaritjen e tatimit mbi mjete motorike.

(2) Me kërkesë të organit doganor kompetent, prodhuesi, përfaqësia ose tregtari i cili është përfaqësues gjeneral ose importues i markës së veçantë të mjeteve motorike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është i detyruar të japë ndihmë profesionale për Drejtorinë Doganore gjatë përcaktimit të të dhënave të rëndësishme për përlogaritjen e tatimit mbi mjete motorike, ndërsa për këtë qëllim duhet të caktojë person kontakti.

(3) Për qëllime të vlerësimit të tatimit mbi mjete motorike, organi doganor kompetent gjatë procedurës ka të drejtë të kërkojë informacionin e nevojshëm për përcaktimin e drejtë dhe të saktë të të dhënave për përlogaritjen e tatimit mbi mjete motorike nga institucionet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe vende të tjera që janë kompetent për sigurimin e informacionit të nevojshëm me qëllim të përlogaritjes së drejtë të tatimit mbi mjete motorike.

(4) Nëse gjatë përcaktimit të tatimit mbi mjete motorike, organi doganor kompetent përcakton se të dhënat mbi bazën e të cilave është vendosur tatimi i automjeteve motorike nuk ishin të vërteta, në këtë rast me aktvendim do të përcaktojë ndryshimin e tatimit që duhet të paguhet.

Neni 12

Dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e emisionit mesatar të dyoksid karbonit CO₂ dhe nivelit të emisionit të gazeve dalëse dalëse

(1) Shuma e emisionit mesatar të dyoksid karbonit CO₂ dhe niveli i emisionit të gazeve dalëse përcaktohet në bazë të vërtetimit për përputhshmërinë për BE-në, lejes së automjetit (Certificate of conformity- COC), në pajtim me regjistrimin e automjetit, vërtetimit nga prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar ose organi kompetent për identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjetit, shuma e emisionit mesatar të dyoksid karbonit - CO₂ në automjetin e kombinuar të shprehur në pajtim me ciklin e vozitjes (New European Driving Cycle-NEDC) ose në pajtim me NEDC të korreluar, nëse mjeti motorik është i homologuar në pajtim me procedurën e harmonizuar të testimit për mjetet e lehta (Worldwide Harmonised Light Vehicle Test Procedure), ndërsa për mjetet motorike që importohen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përveç vërtetimit për përputhshmëri (COC) kërkohet Dëshmi për përmbushjen e standardit për emisionin e gazeve dalëse TIER 2 nga 1999 të cilin e lëshon Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit Jetësor (ERA).

(2) Kur shuma e emisionit mesatar të dyoksid karbonit - CO₂ për mjet motorik nuk mund të konstatohet në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, në atë rast për qëllime të përlogaritjes së tatimit mbi mjetet motorike konsiderohet se shuma e emisionit të dyoksid karbonit CO₂ do të jetë 400 gr/km.

(3) Kur niveli i misionit të gazeve dalëse të automjetit nuk mund të konstatohet në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, në atë rast për qëllim të përlllogaritjes së tatimit mbi mjete motorike konsiderohet se niveli i emisionit të gazeve dalëse të automjetit është në kuadër të vlerave kufitare të parapara për normën Euro 1.

(4) Nëse në procedurat që udhëhiqen për shkak të përdorimit joligjor të mjetit motorik, pala nuk disponon me vërtetim të vlefshëm për shumën e emisionit mesatar të dyoksid karbonit-CO₂ ose të dhëna për nivelin e emisionit të gazeve dalëse të automjetit, organi doganor kompetent nga personi i autorizuar në pajtim me dispozitat nga neni 11, paragrafi (2) dhe (3) të këtij ligji do t'i kërkojë të dhënat për përlllogaritje të tatimit të mjetit motorik. Nëse personi i autorizuar nuk mund t'i konstatojë dhe dorëzojë të dhënat e kërkuara, në atë rast për qëllime të përcaktimit dhe përlllogaritjes së tatimit mbi mjete motorike do të veprohet në pajtim me paragrafët (2) ose (3) të këtij neni.

KAPITULLI 4

PËRCAKTIMI DHE PAGESA E TATIMIT MBI MJETE MOTORIKE

Neni 13

Përcaktimi dhe pagesa e tatimit mbi mjete motorike

(1) Në rast kur mjetet motorike i nënshtrohen tatimit mbi mjete motorike në pajtim me nenin 6 të këtij ligji, përlllogaritja e pagesës së tatimit mbi mjete motorike bëhet me parashtrimin e fletëparaqitjes për pagesë të tatimit mbi mjete motorike në organin doganor kompetent.

(2) Çdo përdorim i mjetit motorik për të cilin nuk është parashtruar fletëparaqitje nga paragrafi (1) i këtij neni konsiderohet si përdorim joligjor i mjetit motorik.

(3) Gjatë krijimit të obligimit për pagesë të tatimit të mjeteve motorike në rastet e përdorimit joligjor të mjetit motorik, tatimin e mjeteve motorike me detyrë zyrtare e përcakton dhe e përlllogarit organi doganor kompetent me miratimin e aktvendimit.

(4) Personi nga neni 7 paragrafi (1) pika 1) të këtij ligji, që kryejnë shitje të mjeteve të reja motorike të prodhuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të detyruar që para shitjes blerësit të fundit ose përdorimit për nevoja personale të parashtrojnë fletëparaqitje nga paragrafi (1) i këtij neni dhe menjëherë ta paguajnë tatimin mbi mjete motorike.

(5) Pronari i mjetit motorik i cili ka kryer riparim të mjetit motorik të llojit tjetër në mjet të lejuar motorik nga neni 6 paragrafi (1), pika 1), 2), 4) dhe 5) të këtij ligji që i nënshtrohet obligimit për pagesë të tatimit mbi mjete motorike para se të bëjë regjistrimin e mjetit motorik duhet të parashtrojë fletëparaqitje nga paragrafi (1) i këtij neni dhe menjëherë ta paguajë tatimin mbi mjete motorike.

(6) Përcaktimi dhe pagesa e tatimit mbi mjete motorike në rastet nga neni 7, paragrafi (1), pika 3) e këtij ligji bëhet në pajtim me rregullat doganore, me ç'rast fletëparaqitja për pagesë të tatimit mbi mjete motorike paraqitet bashkë me deklaratën doganore në pajtim me rregullat doganore, ndërsa pagesa bëhet njëjtë si edhe për tatimet tjera të importit.

(7) Mjetet motorike nga neni 6 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji nuk mund të regjistrohen nëse në procedurë të regjistrimit para organit kompetent për regjistrim të mjeteve motorike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk është paraqitur dëshmi për tatim të paguar të mjeteve motorike në pajtim me nenin 14 të këtij ligji ose dëshmi për përjashtim nga tatimi të mjeteve motorike në pajtim me nenin 18 të këtij ligji.

(8) Nëse organi kompetent për regjistrimin e mjeteve motorike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme dyshon në vlefshmërinë e dëshmisë së paraqitur nga paragrafi (7) i këtij neni ose nëse në raste tjera dyshon se bëhet fjalë për mjet motorik të cilit duhet t'i paguhet tatimi i mjetit motorik, do ta ndërpresë procedurën për regjistrim dhe do të kërkojë mendim nga organi doganor kompetent.

(9) Ministri i Financave i përcakton përmbajtjen, mënyrën e përmbushjes dhe parashtrimin të paraqitjes për pagesën e tatimit mbi mjete motorike.

Neni 14

Dëshmi për tatimin e paguar të mjetit motorik

(1) Faturën të cilën prodhuesi, importuesi, tregtari me mjete të reja motorike ose tregtari me mjete të përdorura motorike ose shitje ia lëshon blerësit të mjetit motorik nga neni 6 paragrafi (1) i këtij ligji, duhet të përmbajë edhe vërejtje se tatimi është përlllogaritur dhe paguar në pajtim me dispozitat e këtij ligji, shumën e tatimit të paguar për mjete motorike dhe numrin e fletëparaqitjes nga neni 13 i këtij ligji me të cilin është paguar tatimi i mjeteve motorike.

(2) Nëse mjeti motorik është importuar për nevoja personale nga ana e personit fizik dhe juridik, si dëshmi për tatimin e paguar konsiderohet fletëparaqitja nga neni 13 i këtij ligji dhe deklarata doganore e importit me të cilën është paguar tatimi për mjete motorike gjatë importit.

(3) Nëse mjeti motorik është blerë në ankand publik, si dëshmi për tatimin e mjeteve motorike konsiderohet vërtetimi të cilin e lëshon organi doganor kompetent te i cili është zbatuar procedura për përcaktimin dhe pagesën e tatimit të mjeteve motorike.

(4) Nëse për mjetin motorik tatimi mbi mjetet motorike është paguar në pajtim me nenin 28 të këtij ligji, si dëshmi për tatimin e paguar mbi mjetet motorike konsiderohet aktvendimi i lëshuar nga organi doganor kompetent në pajtim me nenin 13 paragrafin (3) të këtij ligji me vërtetim se tatimi mbi mjete motorike është paguar.

KAPITULLI 5
PËRJASHTIMI NGA TATIMI MBI MJETET
MOTORIKE

Neni 15

Përrjashtimi nga tatimi ose kthimi i tatimit të paguar mbi mjetet motorike për përfaqësi diplomatike dhe konsullore dhe për organizata ndërkombëtare

(1) Tatimi mbi mjetet motorike nuk paguhet ose kthehet për mjete motorike kur janë dedikuar për:

1) nevoja zyrtare për përfaqësi diplomatike dhe konsullore si dhe misione të veçanta të akredituara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në bazë të parimit të reciprocitetit, përveç për përfaqësitë konsullore të udhëhequra nga konsujt e nderit;

2) nevojat personale të personelit të huaj të përfaqësive diplomatike dhe konsullore dhe misionet e veçanta të akredituara në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

3) nevojat zyrtare të organizatave ndërkombëtare me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kur kjo është përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare të cilën e ka ratifikuar ose zbatohet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

4) nevoja zyrtare të personelit të organizatave ndërkombëtare me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kur kjo është përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare të cilën e ka ratifikuar ose zbatohet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

5) përdorim në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare të cilën Republika e Maqedonisë së Veriut e ka lidhur me shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare, nëse kjo marrëveshje për livrim të mjeteve motorike parasheh përrjashtim nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe

6) nevoja të forcave ushtarake të palëve kontraktuese të Paktit të Atlantikut të Veriut dhe personelit të tyre të huaj.

(2) Përrjashtimi nga tatimi mbi mjetet motorike të dedikuara për personat nga paragrafi (1) pikat 1), 2), 3), 4) dhe 5) të këtij neni, realizohet me paraqitje të vërtetimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme.

(3) Përrjashtimi nga tatimi mbi mjete motorike të dedikuara për personat nga paragrafi (1) pika 6) të këtij neni realizohet në bazë të certifikatës së lëshuar nga forcat ushtarake të palëve kontraktuese të Paktit të Atlantikut të Veriut.

(4) Nëse në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare përrjashtimi mund të realizohet vetëm me kusht të reciprocitetit, përmbushjen e kushtit për reciprocitet e vërteton Ministria e Punëve të Jashtme.

(5) Përrjashtimi nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike gjatë importit ndodh drejtpërdrejt gjatë importit të mjeteve motorike për nevoja zyrtare ose personale të personave nga paragrafi (1) i këtij neni në bazë të vërtetimit të cekur në paragrafin (2) të këtij neni ose certifikatës së cekur në paragrafin (3) të këtij neni.

(6) Përrjashtimi nga tatimi mbi mjete motorike që blihen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për nevoja zyrtare ose personale të personave nga paragrafi (1) i këtij neni, bëhet përmes kthimit të tatimit të paguar mbi mjete motorike.

(7) Me përrjashtim të paragrafit (1) pikës 1) të këtij neni përfaqësitë konsullore të udhëhequra nga konsujt e nderit gjatë importit do të përrjashtohen nga tatimi mbi mjetet motorike në shumë prej 50% të tatimit të përlllogaritur të mjeteve motorike ose do t'u kthehet tatimi personal mjeteve motorike për mjetet motorike që blihen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në shumë prej 50% të tatimit të paguar mbi mjete motorike.

(8) Për realizimin e të drejtës për përrjashtim përmes kthimit të tatimit të paguar mbi mjete motorike nga paragrafi (6) i këtij neni, para regjistrimit të mjetit motorik parashtrohet kërkesë për kthim të tatimit të paguar mbi mjete motorike në organin doganor kompetent.

(9) Organi doganor kompetent në rast nga paragrafi (8) i këtij neni lëshon aktvendim për kthimin e tatimit të paguar mbi mjete motorike.

(10) Gjatë prokurimit të mjeteve motorike në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për nevoja zyrtare ose personale të personave nga paragrafi (1) i këtij neni, kthimi i tatimit të paguar mbi mjete motorike u aprovohet njëherë në tre vite para mbarimit të periudhës trevjeçare, përveç në rastet e prokurimit të domosdoshëm të mjetit të ri motorik si zëvendësim për të vjetrin pas vjedhjes së krijuar ose dëmtimit të rëndë.

(11) Në rastet nga paragrafi (10) i këtij neni, gjatë prokurimit të mjetit të dytë motorik si zëvendësim për mjetin e parë motorik para mbarimit të periudhës trevjeçare për të cilën është aprovuar dhe realizuar kthimi i tatimit të paguar mbi mjete motorike, tatimi i paguar mbi mjetin e dytë motorik kthehet në shumën e cila i përgjigjet në mënyrë adekuate gjatësisë së periudhës kohore në të cilën është shfrytëzuar mjete motorik i cili zëvendësohet.

(12) Mjetet motorike të përrjashtuara nga tatimi mbi mjete motorike në pajtim me nenin 15 nuk guxojnë të tjetërsohen ose të shfrytëzohen për qëllime tjera në afat prej tre vjetësh nëse për të njëjtat nuk paguhet shuma e tatimit të mjeteve motorike për të cilën janë përrjashtuar paraprakisht. Për atë qëllim Ministria e Punëve të Brendshme në lejen e qarkullimit shënon vërejtje "NDALIM PËR TJETËRSIM NË AFAT PREJ TRE VITESH NË PAJTIM ME NENIN 15 PARAGRAFI (12) I LIGJIT PËR TATIM MBI MJETE MOTORIKE".

(13) Ministri i Financave e përcakton mënyrën e përrjashtimit nga tatimi ose kthimit të tatimit të paguar mbi mjete motorike, përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (8) i këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 16

Përrjashtimi nga tatimi ose kthimi i tatimit të paguar mbi mjete motorike gjatë realizimit të projekteve të financuara me mjete në para të donatorëve të huaj

(1) Tatimi mbi mjete motorike nuk paguhet ose kthehet për mjete motorike kur janë dedikuar për:

1) realizimin e projektit të financuar me mjete në para të fituara në bazë të marrëveshjes për donacion, të lidhur ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe donatorëve të huaj, nëse në atë marrëveshje është paraparë se me mjetet e fituara monetare nuk do të paguhet taksa dhe tatime të importit dhe

2) realizimin e projektit të financuar në kuadër të instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) i cili zbatohet në kushte të administrimit të decentralizuar, dhe për pjesën e mjeteve nga bashkëfinancimi nacional i siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose ngarkim me borxh.

(2) Përrjashtimi nga tatimi i mjeteve motorike të dedikuara për implementuesit dhe/ose personat e autorizuar nga ana e implementuesve të projekteve në emër dhe për llogari të implementuesve nga paragrafi (1) i këtij neni, realizohet me paraqitje të vërtetimit të lëshuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Sekretariati për çështje evropiane për regjistrim të projektit që financohet me mjete monetare të donatorëve të huaj.

(3) Gjatë importit të mjeteve motorike të dedikuara për subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni përrjashtimi nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike krijohet gjatë importit në pajtim me rregullat doganore, ndërsa në bazë të vërtetimit të paraqitur nga paragrafi (2) i këtij neni dhe kërkesës së parashtruar për përrjashtim nga tatimi mbi mjete motorike gjatë realizimit të projekteve të financuara me mjete në para të donatorëve të huaj.

(4) Me kërkesën nga paragrafi (3) i këtij neni dorëzohen dokumentet në vijim:

1) Fatura, profatura ose marrëveshja për shitblerje të mjetit motorik në të cilin si blerës është cekur implementuesi dhe/ose personi i autorizuar nga Implementuesi i projektit dhe

2) Vërtetimi për regjistrim të projektit në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Sekretariati i përgjithshëm - Sektori për integrim evropian - Seksioni për koordinim të ndihmës së huaj që përmban të dhënat vijuese:

- titullin e projektit në gjuhën maqedonase dhe angleze,
- vlerën e donacionit për projekt adekuat,
- emrin e implementuesit i cili është i ngarkuar për realizimin e projektit dhe

- datën e marrëveshjes së lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe donatorit të huaj, në të cilën ka klauzolë se mjetet e dhuruara nuk mund të shfrytëzohen për pagesë të taksave publike në Republikën e Maqedonisë.

(5) Mjetet motorike që blihen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e që dedikohen për implementuesit e projekteve nga paragrafi (1) i këtij neni, përrjashtimi nga tatimi i mjeteve motorike bëhet përmes kthimit të tatimit të paguar të mjeteve motorike.

(6) Për realizimin e të drejtës së kthimit të tatimit të paguar mbi mjete motorike nga paragrafi (5) i këtij neni, implementuesi i projektit parashtron kërkesë për kthim të tatimit të paguar mbi mjete motorike në organin doganor kompetent para regjistrim të mjetit motorik.

(7) Me kërkesën nga paragrafi (6) i këtij neni dorëzohen dokumentet në vijim:

1) fatura, profatura ose marrëveshja për shitblerje të mjetit motorik ku si blerës është cekur implementuesi i projektit dhe ku është paraqitur tatimi mbi mjete motorike në pajtim me dispozitat nga neni 14 i këtij ligji dhe

2) vërtetimi për regjistrim të projektit në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Sekretariati i përgjithshëm - Sektori për integrim evropian - Seksioni për koordinim të ndihmës së huaj që përmban të dhënat vijuese:

- titullin e projektit në gjuhën maqedonase dhe angleze,
- vlerën e donacionit për projekt adekuat,
- emrin e implementuesit i cili është i ngarkuar për realizimin e projektit dhe

- datën e marrëveshjes së lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe donatorit të huaj, në të cilën ka klauzolë se mjetet e dhuruara nuk mund të shfrytëzohen për pagesë të taksave publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(8) Organi doganor kompetent në rast nga paragrafi (6) i këtij neni lëshon aktvendim për kthimin e tatimit të paguar mbi mjete motorike.

(9) Mjetet motorike të përrjashtuara nga tatimi mbi mjete motorike në pajtim me dispozitat e këtij neni nuk guxojnë gjatë kohëzgjatjes së projektit të tjetërsohen ose të shfrytëzohen për qëllime tjera përveç për qëllimet e projektit, nëse për të njëjtat nuk paguhet shuma e tatimit mbi mjete motorike për të cilën janë përrjashtuar paraprakisht. Për atë qëllim Ministria e Punëve të Brendshme në lejen e qarkullimit shënon vërejtje: "NDALIM I TJETËRSIMIT NË PAJTIM ME NENIN 16 PARAGRAFI (9) I LIGJIT PËR TATIM MBI MJETE MOTORIKE".

Neni 17

Raste tjera të përrjashtimit nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike

(1) Nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike janë përrjashtuar mjete motorike:

1) që janë dedikuar veçanërisht për gara sportive;

2) që importohen përkohësisht për shkak të pjesëmarrjes në gara sportive, për test vozitje, panaire dhe organizime tjera, të organizuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç'rast importi i përkohshëm i këtyre mjeteve mund të zgjasë më së shumti 30 ditë dhe

3) që janë me status të mjetit me vlerë historike (a.q. Oldtajmer) të prodhuara para 35 vitesh e më shumë, të cilat në pajtim me rregullat për mjete konsiderohen si mjete me vlerë historike.

(2) Mjetet motorike nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxojnë të shfrytëzohen për qëllime tjera (marrje me qira, për shpërbllim, ose të shfrytëzohen për tregti ose aktivitet tjetër afarist), nëse për të njëjtat nuk paguhet shuma e tatimit mbi mjete motorike për të cilën janë përjashtuar paraprakisht.

(3) Realizimi i të drejtës për përjashtim nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike në pajtim me paragrafin (1) pikën 2) të këtij neni, bëhet në pajtim me rregullat doganore me të cilat është rregulluar procedura për përjashtim nga pagesa e taksave të importit gjatë importit të përkohshëm.

(4) Realizimi i të drejtës për përjashtim nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike në pajtim me paragrafin (1) pikat 1) dhe 3) të këtij neni, bëhet në kuadër të procedurës doganore me parashtrim të vërtetimit për përjashtim nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike.

(5) Vërtetim për përjashtim të pagesës së tatimit mbi mjete motorike lëshon organi doganor kompetent pas kërkesës së parashtruar nga ana e importuesit të mjeteve motorike nga paragrafi (1) pika 1) dhe 3) të këtij neni.

(6) Organi doganor kompetent vendos për kërkesën nga paragrafi (5) i këtij neni në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për lëshim të vërtetimit për përjashtim të pagesës së tatimit mbi mjete motorike.

(7) Ministria e Financave e përcakton mënyrën e përjashtimit nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike, formën dhe përmbajtjen e vërtetimit nga paragrafi (4) dhe kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 18

Dëshmia për përjashtim nga tatimi mbi mjetin motorik

(1) Nëse gjatë importit të mjetit motorik është përjashtuar nga tatimi mbi mjete motorike në pajtim me dispozitat nga neni 15 paragrafi (5) ose neni 16 paragrafi (2) të këtij ligji, si dëshmi për përjashtimin nga tatimi mbi mjetin motorik konsiderohet deklarata doganore e importit dhe paraqitja e tatimit mbi mjete motorike nga neni 13 i këtij ligji me të cilat vërtetohet përjashtimi nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike gjatë importit.

(2) Nëse përjashtimi nga tatimi mbi mjete motorike është bërë përmes kthimit të tatimit të paguar për mjetin motorik në pajtim me dispozitat nga neni 15 paragrafi (6)

ose neni 16 paragrafi (5) të këtij ligji, si dëshmi për përjashtim nga tatimi mbi mjete motorike konsiderohet aktvendimi për kthimin e tatimit të paguar për mjete motorike të miratuar në pajtim me dispozitat nga neni 15, paragrafi (9) ose neni 16 paragrafi (8) i këtij ligji.

(3) Gjatë importit të përkohshëm i mjeteve motorike në pajtim me dispozitat nga neni 17, paragrafi (1) pika 2) të këtij ligji, si dëshmi për përjashtim nga tatimi mbi mjetin motorik konsiderohet deklarata doganore e importit dhe aktvendimi për import të aprovuar të përkohshëm të lëshuar nga organi doganor kompetent.

(4) Nëse mjeti motorik është përjashtuar nga tatimi mbi mjete motorike në pajtim me dispozitat nga neni 17 paragrafi (3) të këtij ligji, si dëshmi për përjashtimin nga tatimi mbi mjetin motorik konsiderohet deklarata doganore e importit, paraqitja e tatimit mbi mjete motorike dhe vërtetimi i lëshuar nga organi doganor kompetent në pajtim me dispozitat nga neni 17 paragrafi (4) të këtij ligji, me të cilat vërtetohet përjashtimi nga pagesa e tatimit mbi mjete motorike gjatë importit.

KAPITULLI 6

KTHIMI I TATIMIT TË PAGUAR MBI MJETE MOTORIKE

Neni 19

Kthimi i tatimit të paguar mbi mjete të eksportuara motorike

(1) Personi juridik i cili është importues dhe pronar i mjetit të ri motorik për të cilin është paguar tatimi mbi mjetin motorik në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe i cili është ç'lajmëruar nga evidenca e mjeteve të regjistruara motorike, nëse e eksporton mjetin motorik nga Republika e Maqedonisë së Veriut në afat prej 120 ditësh llogaritur nga data e regjistrimit të parë deri në ditën e eksportit të mjetit motorik, ka të drejtë të kthimit të shumës së përgjithshme nga tatimi i paguar mbi mjetin motorik.

(2) Nëse mjeti motorik për të cilat është aprovuar kthimi i tatimit të paguar mbi mjete motorike përsëri importohet dhe shfrytëzohet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, tatimi mbi mjete motorike përlllogaritet dhe paguhet në pajtim me këtë ligj.

Neni 20

Kërkesa për kthimin e tatimit mbi mjete të eksportuara motorike

(1) Kthimi i tatimit mbi mjete të eksportuara motorike nga neni 19 i këtij ligji bëhet në bazë të parashtrimit të kërkesës për kthim të tatimit mbi mjete të eksportuara motorike në organin doganor kompetent.

(2) Me kërkesën dorëzohet dokumentacioni në vijim:

1) dëshmia se për mjetin motorik është tatimi i paguar mbi mjete motorike në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

2) дëshmi për ç'ljmërim të mjetit motorik nga evidenca e mjeteve të regjistruara motorike të organit kompetent;

3) дëshmi se mjeti motorik është eksportuar nga rajoni doganor i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe

4) дëshmia se personi i ka shlyer borxhet në bazë të detyrimeve tatimore dhe doganore.

(3) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 21

Kthimi i tatimit mbi mjete motorike në raste të veçanta

(1) Për mjetet e reja motorike për udhëtarë nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të këtij ligji, të cilat personat e regjistruar i blejnë për kryerje të veprimtarisë themelore auto taksi transport të udhëtarëve, shuma e tatimit të paguar mbi mjete motorike kthehet në shumë prej 25%.

(2) Për mjetet e reja motorike për udhëtarë nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të këtij ligji, me gjithsej tetë ose nëntë ulëse (përfshirë edhe ulësen e shoferit), të cilat personat e regjistruar i blejnë për kryerje të veprimtarisë themelore auto taksi transport të udhëtarëve, shuma e tatimit të paguar mbi mjete motorike kthehet në shumë prej 80 %.

(3) Për mjetet për banim shuma e tatimit të paguar përkatësisht të përcaktuar të mjeteve motorike kthehet ose zvogëlohet në shumë prej 80%.

(4) Për mjete të reja motorike nga neni 6 paragrafi (1) pika 5) të këtij ligji (tricikla ose katërçikla), që blihen nga ana e personave të regjistruar për kryerje të veprimtarisë themelore higjienë komunale, shuma e tatimit të paguar mbi mjete motorike kthehet në tërësi.

(5) Për mjete të prodhuara ose të importuara mbi mjete të reja motorike nga paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij neni, si dhe mjetet e importuara për banim nga paragrafi (3) të këtij neni, zvogëlimi i tatimit bëhet përmes kthimit të tatimit të paguar të mjeteve motorike, në mënyrë adekuate me përqindjen e përcaktuar nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

(6) Gjatë prodhimit të mjetit për banim nga paragrafi (3) i këtij neni, zvogëlimi i tatimit bëhet drejtpërdrejt gjatë parashtrimit të fletëparaqitjes për pagesë të tatimit mbi mjete motorike. Me fletëparaqitjen parashtrohet faturë ose marrëveshje e shitblerjes për blerje të mjetit për banim.

(7) Mjetet e reja motorike për udhëtarë nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni dhe mjetet e reja motorike për ngarkim nga paragrafi (4) i këtij neni, për të cilat është kryer kthim i tatimit të paguar për mjete motorike në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk guxojnë të tjetërsohen ose të shfrytëzohen për qëllime tjera përveç për qëllimet e cekura në paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij neni, në afat prej tri vitesh duke llogaritur nga dita e regjistrimit të parë të automjetit, përveç nëse për të njëjtat nuk paguhet shuma e tatimit mbi mjete motorike që është kthyer paraprakisht.

Neni 22

Kthimi i tatimit mbi mjete motorike në raste të veçanta

(1) Për realizimin e së drejtës për kthimin e tatimit të paguar, personat nga neni 21, paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij ligji më së voni në afat prej 30 ditësh pas regjistrimit të parë të përfunduar të mjetit nga neni 21, paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij ligji, parashtrojnë kërkesë për kthimin e tatimit të paguar mbi mjete motorike në raste të veçanta, në organin doganor kompetent.

(2) Për realizimin e të drejtës së kthimit të tatimit të paguar, importuesi i mjetit për banim nga neni 21, nga paragrafi (3) i këtij ligji, më së voni në afat prej 30 ditësh pas importit të përfunduar të mjetit parashtron kërkesë për kthimin e tatimit të paguar mbi mjete motorike në raste të veçanta, në organin doganor kompetent.

(3) Me përjashtim të paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, afati për parashtrim të kërkesës mund të vazhdohet për 30 ditë nga afati i paraparë në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni pas aprovimit paraprak nga organi doganor kompetent, për të cilën parashtrohet arsyetim për shkaqet e vonesës së parashtrimit të kërkesës për kthim të tatimit të paguar për mjete motorike.

(4) Organi doganor nga institucione ose organe tjera kompetente mund të kërkojë dokumente plotësuese dhe sqarime në lidhje me dëshmitë për vonesë të parashtrimit të kërkesës për kthim të tatimit mbi mjete motorike.

(5) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, kur bëhet fjalë për blerje të mjetit të ri motorik për udhëtarë nga neni 21 paragrafi (1) të këtij ligji, parashtrohen dokumentet në vijim:

1) дëshmi për veprimtari të regjistruar për auto taksi transport të udhëtarëve;

2) ekstrakt të vlefshëm nga licenca për auto taksi transport të udhëtarëve;

3) leje qarkullimi për mjet të regjistruar motorik për udhëtarë;

4) faturë ose marrëveshje për shitblerje për blerje të mjetit të ri motorik për udhëtarë;

5) fletëparaqitje për tatimin e paguar të mjeteve motorike nga neni 13, paragrafi (1) të këtij ligji;

6) vërtetim se personi i ka paguar borxhet lidhur me detyrimet tatimore dhe doganore;

7) deklaratë se automjeti nuk do të shfrytëzohet për qëllime tjera përveç automjet taksi;

8) vërtetim se kundër personit nuk është ngritur procedurë për falimentim ose likuidim dhe

9) vërtetim se personi nuk është dënuar me vendim gjyqësor të plotfuqishëm me dënim të pakushtëzuar me burg për vepër të kryer penale në fushën e taksave dhe doganave dhe me vendim gjyqësor të plotfuqishëm të mos jetë shqiptuar ndalim për kryerjen e profesionit,

veprimtarisë ose detyrës, ndalim i përkohshëm për kryerjen e një veprimtarie të caktuar dhe ndalimi i përhershëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar.

(6) Me kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, kur bëhet fjalë për blerje të automjetit të ri motorik nga nenin 21 paragrafi (2) të këtij ligji, parashtrohet dokumentet në vijim:

1) dëshmi për veprimtari të regjistruar për transport auto taksi të udhëtarëve ose transport të udhëtarëve;

2) ekstrakt të vlefshëm nga personat për transport auto taksi të udhëtarëve për kryerjen e transport të udhëtarëve;

3) lejeqarkullimi për mjetin e regjistruar motorik;

4) faturë ose marrëveshje për shitblerje për blerje të mjetit të ri motorik për udhëtar;

5) fletëparaqitje për tatimin e paguar të mjeteve motorike nga neni 13, paragrafi (1) i këtij ligji;

6) vërtetim se personi i ka paguar borxhet lidhur me detyrimet tatimore dhe doganore;

7) vërtetim se kundër personit nuk është ngritur procedurë për falimentim ose likuidim;

8) vërtetim se personi nuk është dënuar me vendim gjyqësor të plotfuqishëm me dënim të pakushtëzuar me burg për vepër të kryer penale në fushën e taksave dhe doganave dhe me vendim gjyqësor të plotfuqishëm të mos jetë shqiptuar ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ndalim të përkohshëm për kryerjen e një veprimtarie të caktuar dhe ndalimi i përhershëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar dhe

9) deklaratë se automjeti nuk do të shfrytëzohet për qëllime tjera përveç automjet taksi ose automjet për transportin e udhëtarëve për nevoja zyrtare.

(7) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, kur bëhet fjalë për blerje të automjetit të ri motorik për ngarkesë nga nenin 21 paragrafi (4) të këtij ligji, parashtrohet dokumentet në vijim:

1) dëshmi për veprimtari të regjistruar higjienë komunale;

2) leje qarkullimi për mjetin e regjistruar motorik;

3) faturë ose marrëveshje për shitblerje për blerjen e mjetit të ri motorik;

4) fletëparaqitje për tatimin e paguar të mjeteve motorike nga neni 13, paragrafi (1) të këtij ligji;

5) vërtetim se personi i ka paguar borxhet lidhur me detyrimet tatimore dhe doganore;

6) vërtetim se kundër personit nuk është ngritur procedurë për falimentim ose likuidim;

7) vërtetim se personi nuk është dënuar me vendim gjyqësor të plotfuqishëm me dënim të pakushtëzuar me burg për vepër të kryer penale në fushën e taksave dhe doganave dhe me vendim gjyqësor të plotfuqishëm të mos jetë shqiptuar ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ndalim i përkohshëm për kryerjen e një veprimtarie të caktuar dhe ndalim i përhershëm për kryerje të veprimtarisë së caktuar.

8) deklaratë se automjeti nuk do të shfrytëzohet për qëllime tjera përveç se si mjet ngarkues për kryerjen e veprimtarisë komunale;

(8) Kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni i bashkëngjiten dokumentet në vijim:

1) faturë ose marrëveshje për shitblerje për blerjen e automjetit për banim;

2) deklaratë doganore transporti për automjet të doganuar për banim dhe

3) fletëparaqitje për tatimin e paguar nga neni 13, paragrafi (1) të këtij ligji;

(9) Organi kompetent doganor vendos për kërkesën nga paragrafët (5), (6), (7) dhe (8) të këtij neni në afat prej 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës për kthimin e tatimit mbi mjete motorike.

(10) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

KAPITULLI 7

REGJISTRIMI I PRODHUESVE DHE TREGTARËVE ME MJETE MOTORIKE

Neni 23

Regjistrimi i prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike

(1) Me qëllim të aplikimit të drejtë dhe konsistent të dispozitave për tatimim të mjeteve motorike dhe këmbim të të dhënave me Drejtorinë Doganore, prodhuesi, tregtari me mjete motorike të reja dhe tregtari me mjete motorike, janë të obliguar para fillimit të veprimtarisë së tyre të prodhimit apo tregtisë me mjete motorike në pajtim me këtë ligj, tek organi kompetent doganor të parashtrojnë fletëparaqitje për regjistrim në Regjistrin e prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike.

(2) Regjistri i prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike mbahet në formë elektronike dhe e vendos dhe menaxhon Drejtoria Doganore.

(3) Prodhuesi, tregtari me mjete të reja motorike dhe tregtari me mjete motorike të përdorura si obligues tatimor janë të obliguar me fletëparaqitje për regjistrim në Regjistrin e prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike të parashtrojë dëshmi për plotësimin e kushteve minimale tekniko-teknologjike dhe kushteve tjera për magazinim dhe kryerje të veprimtarisë.

(4) Nëse tregtari me mjete motorike në kuptim të këtij ligji njëkohësisht është tregtar me automjete të përdorura dhe mjete motorike të reja, gjatë parashtrimit të fletëparaqitjes për regjistrim në Regjistrin e prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike, është i obliguar ta njoftojë organin kompetent doganor dhe atë ta paraqes në fletëparaqitje.

(5) Nëse prodhuesi, tregtari për automjete të reja apo tregtari me automjete të përdorura e ndërpret veprimtarinë e tij, organi kompetent doganor pas kërkesës së tij apo me detyrë zyrtare do ta shlyejë nga Regjistri i prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike.

(6) Ministri i Financave e përcakton përmbajtjen e Regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni, formën dhe përmbajtjen e fletëparaqitjes për regjistrim në Regjistrin e prodhuesve dhe tregtarëve me automjete dhe dokumentacionin e nevojshëm.

KAPITULLI 8

MBAJTJA E EVIDENCËS, INFORMIMI DHE KËMBIMI ELEKTRONIK I TË DHËNAVE

Neni 24

Mbajtja e evidencës për mjete motorike

(1) Prodhuesi, tregtari me automjete të reja apo të përdorura në pajtim me këtë ligj, duhet të mbajnë evidencë e cila përmban të dhëna për: markën e mjetit motorik, tipin, variantin, brendin tregtar të mjetit motorik, numrin e identifikimit (numri i shasisë), shenja e motorit, vëllimi i motorit në centimetra kub (cm³), lloji i derivatit për motorin, numri i dyerve, numër i vendeve t'u ulur, nivel i emisionit të gazrave, fuqi e motorit e shprehur në kilovatë (kW), shuma e emisionit mesatar të dyoksid karbonit (CO₂), mënyra e blerjes së mjetit motorik, shteti ku është bërë blerja, data e dërgimit, sasia e mjeteve motorike të prodhuara, të importuara, të blera, të dërguara dhe të shitura, mjete motorike paraprakisht të regjistruara dhe të përdorura, gjendja e rezervave, çmimi i shitjes dhe shuma e tatimit të përlogarit të mjeteve motorike.

(2) Prodhuesi, tregtari i automjeteve të reja dhe me automjete të përdorura mund të zgjedh në mënyrë të pavarur formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës e cila duhet t'i përmbajë të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 25

Raportë mujor

(1) Prodhuesi, tregtari me automjete të reja dhe tregtari me mjete motorike të përdorura në pajtim me këtë ligj, janë të obliguar në bazë të evidencës nga neni 24 i këtij ligji, të përpilojnë dhe tek organi kompetent doganor të parashtrajnë raport mujor në të cilin gjenden të dhënat për mjete motorike të reja dhe/ose të përdorura, të shitura dhe të dërguara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet deri më datën 15 të muajit të ardhshëm për muajin paraprak.

(3) Për periudhën kur nuk ka shitje apo dërgesë të mjeteve motorike nuk ekziston obligimi për parashtrim të raportit mujor.

(4) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e raportit mujor.

Neni 26

Këmbimi elektronik i të dhënave

(1) Paraqitja për pagesë të tatimit mbi mjete motorike nga neni 13 i këtij ligji, kërkesat për kthim të tatimit të paguar për mjete motorike nga neni 15, 16, 20 dhe 22 të këtij ligji, fletëparaqitja për regjistrim në Regjistrin e prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike nga neni 23 i këtij ligji, raporti mujor nga neni 25 të këtij ligji parashtrohen:

1) me sistem të këmbimit elektronik të të dhënave me sistemin kompjuterik të Drejtorisë Doganore ose

2) në formë të shkruar.

(2) Në rast të importit kur fletëparaqitja për pagesë të tatimit mbi mjete motorike nga neni 13 paragrafi i këtij ligji nuk mund të parashtrohet në formë elektronike, atëherë e njëjta parashtrohet në formë të shtypur tek organi kompetent doganor.

KAPITULLI 9

МБИКËQYRJA

Neni 27

Mbikëqyrja në zbatim të ligjit

(1) Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të ligjit e kryen organi kompetent doganor.

(2) Nëse gjatë mbikëqyrjes, organi kompetent doganor konstaton që prodhuesi, tregtari me mjete motorike të reja apo të përdorura nuk mban evidencë nga neni 24 i këtij ligji apo në mënyrë të pasaktë ose jo të plotë e mban dhe për atë nuk mund të konstatohet gjendja dhe obligimi për pagesë të tatimit për mjete motorike, do t'i urdhërojë prodhuesit, tregtarit me mjete motorike të reja apo tregtarit me mjete motorike të përdorura të bëjë regjistrim për mjetet motorike të hasura pa dokumentacion për blerjen apo prodhimin e tyre.

(3) Organi kompetent doganor gjatë mbikëqyrjes tek prodhuesi, importuesi, tregtari me mjete të reja motorike apo mjete të përdorura motorike mund të konstatojë disa nga parregullsitë në vijim:

1) nuk lejon apo e pamundëson zbatimin e mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni;

2) ushtron veprimtari të prodhimit apo shitjes së mjeteve motorike në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut pa regjistrim në Regjistrin e prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike;

3) importuesi, prodhuesi apo tregtari me mjete motorike nuk përlogarit, përlogarit gabimisht ose nuk paguan tatim për mjete motorike;

4) nuk posedon dokumentacion për mjete motorike të prodhuara, të pranuar, të dërguara dhe të shitura lëndë e këtij ligji;

5) nuk mban evidencë të përkufizuar apo në mënyrë të pasaktë ose të paplotë i mban, ose nuk parashtron raporte të përcaktuara;

6) nuk posedon apo nuk e jep në këqyrje dokumentacionin që ka të bëjë me obligimin për përlllogaritje dhe për pagesën e tatimit për mjete motorike, si dhe për dokumentacion tjetër afarist dhe financiar relevant për tatim të automjeteve dhe

7) nuk lëshon fatura në mënyrë të përcaktuar sipas dispozitave të këtij ligji.

(4) Nëse organi kompetent doganor konstaton disa nga parregullsitë nga paragrafi (3) i këtij neni, prodhuesi, importuesi, tregtari me mjete motorike të reja dhe me mjete të përdorura motorike do të përcaktojë afat në të cilin parregullsitë e përcaktuara duhet të mënjanohen.

(5) Nëse në afatin e përcaktuar nga paragrafi (4) i këtij neni, prodhuesi, importuesi, tregtari me mjete motorike të reja ose mjete motorike të përdorura nuk i mënjanon parregullsitë, organi kompetent doganor mund të iniciojë procedurë për arkëtim shtesë të tatimit mbi mjet motorik dhe/ose procedurë për shlyerje të prodhuesit apo tregtarit me mjete motorike të reja apo të përdorura nga regjistri i prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike.

(6) Nëse gjatë mbikëqyrjes konstatohet që tatimi mbi mjete motorike nuk është përlllogaritur apo është përlllogaritur në mënyrë të pasaktë nga ana e prodhuesit, importuesit apo tregtarit me mjete motorike, organi kompetent doganor me aktvendim do ta përcaktojë shumën e saktë të tatimit mbi mjete motorike dhe afatin për pagesë.

(7) Nëse prodhuesi, importuesi apo tregtari me mjete të reja apo të përdorura motorike nuk e paguan tatimin mbi mjete motorike në afatin sipas paragrafit (6) të këtij neni, organi kompetent doganor me aplikim adekuat të nenit 29 të këtij ligji mund t'i ndërmerr të gjitha masat, duke përfshirë edhe konfiskim dhe shitje të mjeteve motorike në rast të kundërvajtjes së kryer nga paragrafi (6) i këtij neni.

(8) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni, organi kompetent doganor me aktvendim e shlyen prodhuesin apo tregtarin me mjete motorike të reja apo të përdorura nga regjistri i prodhuesve dhe tregtarë me mjete motorike. Prodhuesi apo tregtari me mjete motorike të reja apo të përdorura që duhet të shlyhet nga Regjistri i prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike, sërish mund të regjistrohet në regjistrin, nëse në momentin e paraqitjes për regjistrim, nuk ka borxhe të mbetura, në bazë të obligimeve tatimore dhe doganore dhe nëse nuk ekzistojnë shkaqet e përmendura në paragrafin (3) të këtij neni në bazë të të cilave përkohësisht mund t'i ndalohet prodhuesit, tregtarit me mjete motorike të reja ose të përdorura ta ushtrojë veprimtarinë e tij.

Neni 28

Përdorimi i paligjshëm i mjetit motorik

(1) Nëse konstatohet që mjeti motorik është regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa për atë tatimi mbi mjete motorike nuk është paguar ose nuk është paguar në tërësi, apo nëse konstatohet se mjeti motorik është regjistruar në bazë të dokumenteve të rrejshme ose të falsifikuara, konsiderohet që mjeti motorik është lëndë e përdorimit të paligjshëm në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, organi kompetent doganor është i obliguar të ndërmerr masa për sigurim të pagesës së tatimit mbi mjete motorike në pajtim me nenin 29 të këtij ligji dhe varësisht nga rasti dhe nëse kjo është proporcionale me qëllimin që duhet të arrihet, nga Ministria e Punëve të Brendshme si organ kompetent për regjistrim të mjeteve motorike të kërkojë anulim të regjistrimit të mjetit motorik. Ministria e Punëve të Brendshme me kërkesë të Drejtorisë Doganore e anulon regjistrimin e mjetit motorik.

(3) Nëse në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni konstatohet që përdorimi ligjor i mjetit motorik është pasojë e mashtrimit dhe/ose keqpërdorimit të besimit dhe/ose ndërmarrje të veprimeve fiktive ose imagjinare nga ana e personit i cili në mënyrë të paligjshme ka përdorur mjet motorik krahas personit i cili i ka ndërmarrë ato vepra do të konsiderohet edhe çdo person tjetër për të cilin nga rrethanat objektive rezultojnë se ka qenë i vetëdijshëm ose ka qenë i detyruar ta dijë që me veprimin e tij ose me mosndërmarrje të masave obligative merr pjesë në përdorim të paligjshëm të mjetit motorik.

Neni 29

Marrja e përkohshme e mjetit motorik

(1) Nëse ekziston rrezik që personi i cili në mënyrë të paligjshme ka përdorur mjet motorik, në marrëveshje me persona të tretë apo në mënyrë tjetër mund ta parandalojë apo konsiderueshëm ta vështirësojë pagesën e tatimit mbi mjete motorike, përkatësisht nëse nga rrethanat rezultojnë që pagesa e tatimit nuk është e sigurt, organi kompetent doganor, nëse kjo është proporcionale me qëllimin që duhet të arrihet, mund përkohësisht ta marrë mjetin motorik me qëllim të sigurojë pagesë të tatimit mbi mjete motorike.

(2) Për shkak të sigurimit të arkëtimit të tatimit për mjete motorike, organi kompetent doganor do të lëshojë vërtetim për marrje të përkohshme të mjetit motorik nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe do të miratojë aktvendim me të cilin do të përcaktojë masa për vënie nën mbikëqyrje të mjetit motorik deri në zbatim të aktvendimit për arkëtim të tatimit mbi mjete motorike.

(3) Organi kompetent doganor do ta ndërpresë zbatimin e masave nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse personi i cili në mënyrë të paligjshme e ka përdorur mjetin motorik parashtron garanci për sigurim të pagesës së tatimit mbi mjete motorike, nëse zbatimi i atyre masave më nuk është në proporcionalitet me qëllimin që duhet të arrihet apo nëse duhet të ndërpritet procedura për arkëtim të tatimit mbi mjete motorike.

(4) Shuma e garancisë nga paragrafi (3) i këtij neni duhet të përshtatet me shumën më të lartë të tatimit mbi mjete motorike që mund të ndodh për mjet motorik që ka qenë lëndë e përdorimit të paligjshëm.

(5) Organi kompetent doganor mund të miratojë parashtrim të garancisë për sigurim të pagesës së tatimit mbi mjete motorike nga ana e ndonjë personi tjetër në vend të personit i cili në mënyrë të paligjshme e ka përdorur mjetin motorik.

(6) Pranimi i garancisë për sigurim të pagesës së tatimit mbi mjete motorike nga paragrafi (3) i këtij neni dhe arkëtimi nga mjetet e garancisë bëhet në mënyrë të përcaktuar në pajtim me dispozitat nga Ligji për procedurë tatimore.

(7) Nëse pas zbatimit të aktvendimit për arkëtim për mjete motorike për mjetin motorik për të cilin është konstatuar se është përdorur në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut konstatohet që tatimi nuk është paguar, as nuk është parashtruar shumë adekuate për garanci, organi kompetent doganor në rast kur mjeti motorik është marrë në pajtim me dispozitat në paragrafin (1) të këtij neni dhe është vendosur nën mbikëqyrje, me aktvendim për zbatim do ta marrë mjetin motorik dhe do ta vë në shitje.

(8) Organi doganor grumbullimin, ruajtjen dhe shitjen e mjeteve motorike lëndë të përdorimit të paligjshëm mund t'ia besojë për zbatim Agjencisë për Menaxhim me Pronë të Konfiskuar.

(9) Mjetet e realizuara nga shitja e mjetit motorik nga paragrafi (7) të këtij neni sistemohen në mënyrë që së pari arkëtohet tatimi për mjete motorike dhe kamatat, pastaj shpenzimet e procedurës (shpenzimet për grumbullim, ruajtje dhe shitje), ndërsa pjesa tjetër e mjeteve i kthehen personit i cili në mënyrë të paligjshme e ka përdorur mjetin motorik, me çka borxhi në bazë të tatimit për mjete motorike konsiderohet i mbyllur në pjesën e të ardhurave të realizuara me shitjen e mjetit motorik.

KREU 10

PROCEDURA PAS PADISË

Neni 30

Procedura pas padisë

(1) Kundër aktit administrativ të miratuar nga ana e organit kompetent doganor në pajtim me këtë ligj, mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(2) Padia nuk e prolongon ekzekutimin e aktit administrativ.

PJESA E TRETË

DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE

KREU 11

DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE

Neni 31

Procedura kundërvajtëse

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 34 dhe neni 35 paragrafët (1), (2) dhe paragrafin (3) alinetë 1 dhe 3 të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse udhëheq dhe sanksion kundërvajtës shqipton organi kundërvajtës i përcaktuar me Ligjin për Drejtori Doganore.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 35 paragrafin (3) alinenë 2 të këtij ligji, procedurën kundërvajtëse e udhëheq gjykata kompetente.

Neni 32

Procesverbali dhe urdhërpagesa kundërvajtëse

(1) Pas zbulimit të kundërvajtjes, nëpunësi doganor është i detyruar të përpilojë procesverbal. Procesverbalin e nënshkruan nëpunësi doganor dhe kryerësi.

(2) Nëpunësi doganor menjëherë pas përpilimit të procesverbalit nga paragrafi (1) i këtij neni, për kundërvajtje të përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji kryesit të kundërvajtjes i lëshon urdhërpagesë kundërvajtëse dhe atë do ta shënojë në procesverbalin për kundërvajtje të konstatuar.

(3) Kryesi i cili me largim për shkak të qëndrimit jashtë vendit mund të shmangte pagimin e gjobës së shqiptuar me urdhërpagesë kundërvajtëse, është i detyruar të paguajë gjobën menjëherë.

(4) Nëpunësi doganor përgjegjës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse mund ta marrë përkohësisht dokument udhëtimi ose letërnjoftim për të huaj dhe patentë shoferi, deri sa të mos i dorëzohet prova se gjoba është e paguar, por jo më gjatë se tetë ditë nga dita e marrjes.

(5) Nëse kryerësi nuk pajtohet t'i lëshohet ose refuzon të nënshkruajë urdhërpagesën kundërvajtëse ose për kundërvajtje të kryer me këtë ligj nuk është përcaktuar lëshimi i urdhërpagesës kundërvajtëse, e njëjta do të shënohet në procesverbalin për kundërvajtje të konstatuar, kurse nëpunësi doganor i autorizuar paraqet kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse para organit kundërvajtës nga neni 31 të këtij ligji.

Neni 33

Parashkrimi

(1) Procedura kundërvajtëse pas kundërvajtjes të këtij ligji nuk mund të ngrihet nëse kanë kaluar më shumë se katër vjet nga dita e kryerjes së kundërvajtjes.

(2) Nëse bëhet fjalë për kundërvajtje të vazhdueshme ose të përsëritur, afati i parashtrimit fillon të rrjedhë nga dita e veprimit të fundit të kundërvajtjes.

(3) Parashkrimi nuk rrjedh për kohën në të cilën sipas ligjit ndjekja nuk mund të fillojë ose të vazhdojë.

(4) Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim procedural që ndërmerret për shkak të ndjekjes së kryerësit të kundërvajtjes, si dhe kur kryerësi në kohën deri sa rrjedh afati i parashkrimit kryen kundërvajtje më të rëndë.

(5) Pas çdo ndërprerje parashkrimi fillon të rrjedhë sërish.

(6) Parashkrimi për ndjekje kundërvajtëse ndodh në çdo rast kur ka kaluar dy herë më shumë kohë sa është përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 34

Kundërvajtjet lidhur me mosplotësimin e detyrimeve

(1) Gjobë në shumë prej 50 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik mikro tregtar ose tregtar i vogël, kurse gjobë në shumë prej 250 deri në 1.000 euro do t'i shqiptohet personit juridik tregtar i mesëm dhe tregtar i madh si dhe gjobë në shumë prej 15 deri në 250 euro do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik ose personit fizik, nëse:

1) vepron në kundërshtim me nenin 11 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

2) në fletëparaqitjen për pagimin e tatimit mbi mjete motorike jep informacione të pavërteta në bazë të të cilave përcaktohet baza tatimore, (neni 11 paragrafi (4));

3) nuk paraqet fletëparaqitje për pagimin e tatimit mbi mjete motorike në mënyrën dhe afatin e përcaktuar në nenin 13 paragrafët (1), (4), (5) dhe (6) të këtij ligji;

4) kryen veprimtari të prodhimit ose shitjes të automjeteve motorike në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut pa paraqitur kërkesë për regjistrim në Regjistrin e Prodhuesve dhe Tregtarëve të Automjeteve Motorike në përputhje me nenin 23 paragrafin (1), ose nuk paraqet kërkesë për tërheqje nga Regjistri në përputhje me nenin 23 paragrafin (5);

5) nuk mban evidencë ose në pajtim me nenin 24 paragrafin (1);

6) nuk dorëzon raporte mujore (neni 25 paragrafi (1) dhe (2));

7) mjeti motorik është i regjistruar në bazë të dokumenteve të rrejshme ose të falsifikuara (neni 28 paragrafi (1));

8) Automjetin e shfrytëzon në kundërshtim me dispozitat nga neni 9 paragrafi (9) dhe neni 17 paragrafi (2) të këtij ligji;

9) nuk lejon ose e pamundëson zbatimin e mbikëqyrjes (neni 27 paragrafi (1));

10) nuk posedon dokumentacion për mjete motorike të prodhuara, të pranuar, dorëzuara dhe të shitura lëndë e këtij ligji (neni 27 paragrafi (2) pika 4));

11) nuk posedon ose nuk e vë në kontroll dokumentacionin e lidhur me llogaritjen për pagimin e tatimit mbi mjete motorike, si dhe të dokumentacionit tjetër afarist dhe financiar për tatimin e automjeteve, (neni 27 paragrafi (2) pikat 5) dhe 6));

12) nuk lëshon ose lëshon faturë në kundërshtim me nenin 14 paragrafin (1) të këtij ligji;

13) e pengon zbatimin e marrjes së përkohshme të automjetit motorik (neni 29 paragrafi (1)) dhe

14) nuk dorëzon regjistrim të mjeteve motorike të importuara të doganuara, të pa shitura dhe pa regjistruara në pajtim me detyrimin nga neni 39 paragrafi (1).

(2) Pas përcaktimit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) të këtij neni nëpunësi doganor kryerësit të kundërvajtjes do t'i dorëzojë urdhërpagesë kundërvajtëse me gjobë në shumë të gjobës minimale të përcaktuar për kundërvajtje të kryer.

(3) Pas pranimit dhe nënshkrimit të urdhërpagesës kundërvajtëse, kryerësi është i detyruar të paguajë gjobën e shqiptuar në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, në afat prej tetë ditëve nga pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse, në llogarinë e theksuar në urdhërpagesë, gjatë së cilës do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, për të cilën të drejtë këshillohet në këshillën juridike.

(4) Nëse kryerësi nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, nëpunësi doganor paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse të organi kundërvajtës kompetent nga neni 31 i këtij ligji.

Neni 35

Kundërvajtjet lidhur me mospagimin e tatimit

(1) Gjobë në shumë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet personit juridik mikro tregtar dhe tregtar i vogël, respektivisht gjobë në shumë prej 250 deri në 500 euro do t'i shqiptohet personit juridik tregtar i mesëm dhe tregtar i madh kurse gjobë në shumë prej 15 deri në 100 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik ose personit fizik, kur vlera e mjetit motorik është deri 5.000 euro nëse:

1) vepron në kundërshtim me nenin 11 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji me qëllim të shmangies së pagimit të tatimit mbi mjetin motorik ose pagimin në shumë më të vogël;

2) nuk parashtron fletëparaqitje dhe/ose nuk e paguajë tatimin mbi mjete motorike në afatin e përcaktuar dhe/ose e paguan tatimin mbi mjetin motorik në shumë më të vogël nga e përcaktuara (neni 13 paragrafët (1), (4), (5) dhe (6));

3) vepron në kundërshtim me nenin 17 paragrafin (2) të këtij ligji;

4) fillon të kryejë veprimtari të prodhimit ose shitjes së mjeteve motorike pa regjistrim të kryer në Regjistrin e prodhuesve dhe tregtarëve me mjete motorike (neni 23 paragrafi (1));

5) blen, shet, merr dhuratë, fsheh, pranon në ruajtje ose për transport, ruan, përdor ose merr në pronësi në cilëndo bazë, automjetet për të cilin në mënyrë të përcaktuar nuk është llogaritur ose paguar tatimi mbi mjete motorike (neni 7 paragrafi (2)) dhe

6) nëse konfirmohet se tatimi mbi mjete motorike nuk është paguar ose nuk është paguar plotësisht (neni 28 paragrafi (1)).

(2) Gjohë me shumë prej 250 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë, për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, do t'i shqiptohet personit juridik mikro tregtar dhe tregtarit të vogël, përkatësisht me shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik tregtar i mesëm dhe tregtar i madh, ndërsa gjohë me shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personit juridik ose personit fizik, kur vlera e mjetetit motorik është prej 5.000 deri 15.000 euro.

(3) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni do të shqiptohet:

- gjohë me shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, personit juridik mikro tregtar ose tregtar i vogël,

- gjohë me shumë prej 1.000 deri 12.000 euro në kundërvlerë me denarë, për personin juridik tregtar i mesëm dhe gjohë me shumë prej 1.000 deri 20.000 euro në kundërvlerë me denarë, për personin juridik tregtar i madh dhe

- gjohë me shumë prej 250 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë, për personin përgjegjës në personit juridik ose 250 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë për personin fizik, kur vlera e mjetetit motorik është mbi 15.000 euro.

(4) Mjeti motorik dhe/ose pajisja për prodhimin e mjetetit motorik e përfshirë me kundërvajtje nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, konfiskohen.

(5) Mjeti motorik dhe/ose pajisja nga paragrafi (4) i këtij neni konfiskohen edhe kur nuk janë në pronësi të kryerësit të kundërvajtjes, nëse pronari i tyre e ka ditur ose duke pasur parasysh rrethanat në rastet do të mund ta dinte se janë lëndë e kundërvajtjes nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni.

(6) Nëse mjeti motorik dhe pajisja nga paragrafi (4) e këtij neni nuk gjenden, nga kryerësi i kundërvajtjes arkëtohet vlera e tyre dhe ngrihet procedurë për pagimin e tatimit mbi mjetin motorik në ç'rast nëse ka më shumë kryerës të kundërvajtjes, për pagimin e vlerës së automjetit përgjigjen në mënyrë solidare. Konsiderohet se mjeti

motorik lëndë e kundërvajtjes nuk është gjetur dhe nëse nga cilido shkak nuk është e mundur t'i konfiskohet pronarit.

(7) Zbatimi i paragrafëve (4), (5) dhe (6) të këtij neni nuk ndikojnë në të drejtat e tre personave për kompensim të dëmit të shkaktuar nga kryerësi i kundërvajtjes.

PJESA E KATËRT
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

KREU 12
DISPOZITA PËR ZBATIM

Neni 36

Nomenklatura e Tarifës doganore

Për shenjat e tarifave të përmendura në këtë ligj zbatohet tarifa doganore.

KREU 13
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 37

Dispozitat nënligjore

Dispozitat nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 38

Mjetet motorike nën mbikëqyrje doganore

Për mjetet motorike të cilat në ditën e zbatimit të këtij ligji gjenden nën mbikëqyrje doganore në pajtim me dispozitat doganore dhe nuk janë lëshuar në qarkullim të lirë, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 39

Regjistrimi i mjeteve motorike të importuara, të pashitura dhe të paregjistruara

Mjetet motorike të cilat nga dita e zbatimit të këtij ligji nuk janë importuar nga ana e personave juridikë dhe për të cilat janë paguar detyrimet e importit, duke përfshirë edhe akcizën në pajtim me dispozitat e Ligjit për akciza (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 32/2001, 50/2001, 45/2002,98/2002, 24/2003, 96/2004, 38/2005, 88/2008, 105/2009, 34/10, 24/11, 55/11, 135/11,82/13, 43/14, 167/14, 188/14, 129/15, 154/15, 192/15, 23/16, 171/17 dhe120/18), që ende nuk janë shitur dhe/ose nuk janë regjistruar, importuesit ose tregtarët të cilët të njëjtat i posedojnë janë të obliguar deri më 31 dhjetor 2019 të bëjnë regjistrim të të gjitha mjeteve motorike të importuara dhe të doganuara, të pashitura dhe të paregjistruara dhe të njëjtin në afat prej 15 ditësh ta dorëzojnë në Drejtorinë Doganore me të dhënat për: markën e mjetetit motorik,

llojin, variantin, emrin tregtar të automjetit, numrin identifikues (numrin e shasisë), shenjën e motorit, masën përfshirëse të motorit në centimetra kub (cm³), llojin e derivatit, numrin e dyerve, numrin e ulëseve, nivelin e emisionit të gazrave, fuqinë e motorit të shprehur në kilovat (kW), shumën e emisionit mesatar të dioksidit të karbonit (CO₂), shtetin e eksportit, shumën e paguar të akcizave, numrin dhe datën e deklaratave importuese doganore dhe vendosmërinë doganore të doganimit të importit.

Neni 40

Mjetet e importuara të paregjistruara

(1) Të gjithë personat të cilët posedojnë mjete motorike në pajtim me dispozitat e këtij ligji të cilat deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, kanë kryer import të mjeteve motorike dhe i kanë paguar detyrimet, duke përfshirë edhe akcizën, ndërsa nuk janë të regjistruara, në afat prej një viti nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji, gjatë regjistrimit të automjeteve motorike, mund të dorëzojnë deklaratë improtuese doganore për detyrimet e paguara.

(2) Pas kalimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, personat të cilët posedojnë automjete motorike nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërsa ende nuk janë të regjistruar, deri te organi kompetent doganor, në afat prej pesë vjetëve nga data e deklaratës doganore të importit, mund të dorëzojnë kërkesë për lëshimin e vërtetimit për dhënat e paguara importuese për automjete motorike të doganuara. Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga data e deklaratës doganore të importit, organi kompetent doganor nuk do të lëshojë vërtetim për detyrimet e paguara improtuese për automjetin motorik të doganuar.

(3) Pas kalimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, gjatë regjistrimit të mjetit motorik nga paragrafi (1) i këtij neni, pronarët e mjetit motorik detyrimisht duhet të dorëzojnë vërtetim për të dhënat e paguara importuese për mjetin motorik të doganuar të lëshuar nga organi kompetent doganor në pajtim me dispozitat e paragrafit (2) të këtij neni. Përkundrazi, organi kompetent për regjistrimin e mjetit do ta refuzojë regjistrimin e automjetit, ndërsa personin ta udhëzojnë në plotësimin e obligimit nga paragrafi (2) të këtij neni.

(4) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni dhe formën dhe përmbajtjen e Vërtetimit për detyrimet importuese për mjetin motorik të doganuar dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 41

Procedurat e filluara

Procedurat e filluara për import të mjeteve motorike nga neni 6 paragrafi (1) të këtij ligji, për të cilat janë dorëzuar edhe deklaratat doganore të importuesve të regjistruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me Ligjin për akciza ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 32/2001, 50/2001, 45/2002, 98/2002, 24/2003, 96/2004, 38/2005, 88/2008, 105/2009, 34/10, 24/11, 55/11, 135/11, 82/13, 43/14, 167/14, 188/14, 129/15, 154/15, 192/15, 23/16, 171/17 dhe 120/18).

Neni 42

Hyrja në fuqi e këtij ligji

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2020.

4044.

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

У К А З**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА КОНЦЕСИИ И ЈАВНО ПРИВАТНО ПАРТНЕРСТВО**

Се прогласува Законот за за изменување и дополнување на Законот за концесии и јавно приватно партнерство,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 18 декември 2019 година.

Бр. 08-6862/1
18 декември 2019 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
Ство Пендаровски, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi, с.р.**

ЗАКОН**ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА КОНЦЕСИИ И ЈАВНО ПРИВАТНО ПАРТНЕРСТВО**

Член 1

Во Законот за концесии и јавно приватно партнерство („Службен весник на Република Македонија“ број 6/12, 144/14, 33/15, 104/15 и 215/15 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ број 153/19), по членот 41 се додава нов член 41-а, кој гласи:

„Член 41-а

По исклучок од членот 41 став 7 од овој закон во случај на промена на пропис, кога Владата во име на Република Северна Македонија како концедент, според претходна направена анализа на проценка на економската оправданост за дел од предметот на концесијата ќе оцени дека нема повеќе економска оправданост, а по претходна обезбедена согласност од концесионерот, Владата на Република Северна Македонија може да донесе одлука за склучување на анекс на договорот за концесија за промена на намената на дел од средствата, но само за инвестирање во објекти од јавен интерес, во висина на износот кој бил потребен за спроведување на тој дел од предметот на концесија.

Анализата за проценка на економската оправданост од ставот 1 на овој член ја изготвува Владата на Република Северна Македонија.

Во одлуката од ставот 1 на овој член, се утврдува намената на средствата, износот на средствата кои биле потребни за спроведување на дел од предметот на концесијата, начинот и динамиката на реализацијата на намената на средствата, согласно со правата и обврските на концесионерот и концедентот утврдени со договорот за концесија.“

Член 2

Одредбите од овој закон кои се однесуваат на можноста за склучување на анекс на договор на концесија, ќе се применуваат една година од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Концесионерите кои до денот на влегувањето во сила на овој закон, имаат склучено договор за концесија ќе можат да склучат анекс на договор за концесија согласно со одредбите од овој закон во рокот утврден во ставот 1 на овој член.

Член 3

Во целиот текст на законот зборовите: „Република Македонија“ се заменуваат со зборовите: „Република Северна Македонија“.

Член 4

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KONCESIONE DHE PARTNERITET PRIVAT PUBLIK

Neni 1

Në Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 6/12, 144/14, 33/15, 104/15 dhe 215/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 153/19), pas nenit 41 shtohet nen i ri 41-a, si vijon:

“Neni 41-a

Me përjashtim nga neni 41 paragrafi 7 të këtij ligji në rast të ndryshimit të rregullës, kur Qeveria në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut si koncedent, sipas analizës së bërë paraprakisht të vlerësimit të arsyeshmërisë ekonomike për një pjesë të lëndës së koncesionit do të vlerësojë se nuk ka më arsyeshmëri ekonomike, e pas pëlqimit të siguruar paraprakisht të koncesionarit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të miratojë vendim për lidhje të aneksit të marrëveshjes për koncesion për ndryshimin e dedikimit të një pjese të mjeteve, por vetëm për investim në objekte me interes publik, në lartësinë e shumës që ka qenë e nevojshme për zbatimin e asaj pjese të lëndës së koncesionit.

Analizën për vlerësimin e arsyeshmërisë ekonomike nga paragrafi 1 i këtij neni, e përgatit Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet dedikimi i mjeteve, shuma e mjeteve që ka qenë të nevojshme për zbatimin e një pjese të lëndës së koncesionit, mënyra dhe dinamika e realizimit të dedikimit të mjeteve, në pajtim me të drejtat dhe obligimet e koncesionarit dhe koncedentit, të përcaktuara me marrëveshje për koncesion.“

Neni 2

Dispozitat e këtij ligji që i referohen mundësisë për lidhjen e aneksit të marrëveshjes së koncesionit, do të zbatohen një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Koncesionarët të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë lidhur marrëveshje për koncesion, do të mund të lidhin aneks të marrëveshjes për koncesion, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 3

Në të gjithë tekstin e ligjit fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.



СЛУЖБЕН ВЕСНИК

на Република Северна Македонија




www.slvesnik.com.mk

contact@slvesnik.com.mk

Издавач: ЈП СЛУЖБЕН ВЕСНИК НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА, ц.о. – Скопје
бул. „Партизански одреди“ бр. 29. Поштенски фах 51.
Директор и одговорен уредник – Мартин Костовски
телефон: +389-2-55 12 400
телефакс: +389-2-55 12 401

Претплатата за 2019 година изнесува 10.100 денари.
„Службен весник на Република Северна Македонија“ излегува по потреба.
Рок за рекламации: 15 дена.
Жиро-сметка: 300000000188798.
Депонент на Комерцијална банка, АД – Скопје.
Печат: Печатница ЕВРОПА 92 ДООЕЛ, Кочани.
Цената на овој број е 120 денари.

ISSN 0354-1622



2019261